R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 5, datë 17.07.2026

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 10:10
Data e mbajtjes së mbledhjes : 17.07.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi : Përshëndetje!
Të nderuar këshilltarë ! E nderuar kryetare e bashkisë!
Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës.
Në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Gjithashtu na ka ardhur dhe një informacion për trajtimin e 13 familjeve në pallatin tek rruga “Muhamet Velia”, të cilin mendoj ta diskutojmë në fund.
Ftoj sekretaren të bëj prezencën.

Dorina Milja: Fillojmë.
Ardian Muka ...……deri tek…. Florian Tahiri….
33 Këshilltarë në sallë.

V.O *(Hyn me vonesë në sallë këshilltarët: Samet Vata dhe Bledar Prizreni , të cilët largohen nga salla kur po shqyrtohej pika 2 e rendit të ditës, në fund ikën dhe Anila Kapedani nga salla).*

Denisa Luarasi: Faleminderit, Dori.
Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me rendin e ditës.
Po, Flutura.

Flutura Kasa: Po marr shkas pak nga votimi i djeshëm në Kryesinë e Këshillit Bashkiak, te shtesat e tre pikave të fundit që ishin për tërmetin. Doja të thoja vetëm diçka. Opozita ka të drejtën e vet për të kundërshtuar, por diçka është jashtë logjikës njerëzore, sepse ne këtu jemi me votat e atyre njerëzve, që janë jashtë dhe çohet opozita të votojë kundër, përveç zotit Nezha, për tre pikat e tërmetit, dhe pastaj të bëjë moral që bëjnë namin për njerëzit. Kjo veç e moralshme nuk është, kur njerëzit mezi presin jashtë për të përfunduar dhe për të shpëtuar nga problemet e tërmetit. Kështu që ose mbajeni fjalën që thoni : .... ne për problemet që janë direkt me komunitetin jeni pro....., ose mos bëni deklarata kur nuk e mbani fjalën, sepse në mbledhjen e fundit një pikë na ka ardhur në darkë, një ditë para mbledhjes, dhe ishim dakord vetëm se ishte për tërmetin, dhe opozita e votoi në Kryesi. Kurse kjo që erdhi dy ditë para, pas shumë hartimesh që bëjnë, thanë : Jo.
Prandaj e fola, meqë këta thonë që po flasim të dëgjojnë njerëzit. Edhe unë po flas që të dëgjojnë njerëzit se për tre pikat e tërmetit në Kryesi përfaqësuesit e opozitës kanë votuar kundër, dhe ky është ai preokupimi i madh që kanë për komunitetin.
Dhe, e fundit, zonja kryetare, të lutem shumë, respekto kohën. Nuk është 10 minuta për kryetarët e grupit për çdo pikë, por janë 10 minuta nga fillimi deri në fund.

Denisa Luarasi: Ok. Faleminderit.
Faleminderit shumë.
Atëherë, po Muka.

Ardian Muka: Më vjen keq për dezinformimin që bën zonja këshilltare. Thelbi i asaj çfarë ne kemi kërkuar me votën tonë kundra ka pasur lidhje me performancën e bashkisë. Duhet ta kemi parasysh, ta ketë parasysh edhe zonja këshilltare, që kjo është mbledhje jashtë radhe. Ka një procedurë pak më ndryshe sesa mbledhjet e zakonshme apo edhe mbledhjet e jashtëzakonshme. Thirret nga kryetarja, thirret nga një e treta e këshilltarëve, thirret edhe nga prefekti, dhe specifikat e kësaj mbledhjeje janë të përcaktuara.
Po të lexoni nenin 53, unë e kam theksuar edhe te komunikimet që kemi pasur bashkë. Them që duhet të jetë kryetari ai që paraqet, dhe kryetarja, me të drejtë, paraqiti pesë-gjashtë pikat e para. Më mbarapa u paraqitën edhe tre pikat e tjera, dhe insistimi jonë, si në mbledhjen e kaluar, ashtu edhe në mbledhje të tjera, ka qenë që nga ana e administratës së bashkisë të jenë më korrektë në respektimin e asaj çfarë thuhet dhe në rregullore, edhe në atë ça ka dhe ligjin për pushtetin vendor. Pra, pesëditëshi duhet respektuar, në mënyrë që ne të kemi kohë të bëjmë, edhe kur vimë nëpër komisione, dhe kur të vijmë për të diskutuar këtu, të kemi të gjithë informacionin e domosdoshëm, në mënyrë që të jemi sa më konkretë. Kaq. Për këtë ka qenë vota kundër. Nuk ka lidhje me

tërmetin. E kemi thënë: "..çdo material që do të vijë në lidhje me tërmetin, por jo vetëm për hallet e qytetarëve, opozitën do ta kenë gjithmonë krah".
Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, Muka.
Të lutem, Flutura, e sqaruam.
Fillojmë me rendin e ditës, ju lutem.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN KORRIK 2026
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026-2030 NË BASHKINË DURRËS
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2,433,796 (DY MILIONË E KATËRQIND E TRIDHJETË E TRE MIJË E SHTATËQIND E NËNTËDHJETË E GJASHTË) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI EDEN-ECOLOGICAL DEVELOPMENT THROUGH FARMING FOR ENHANCING THE URBAN ENVIRONMENT, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027)
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT NË FORMËN E TRANSFERTËS TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE NË KODIN AD, PËR OBJEKTIN "MURE MBAJTËS NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 1 DHE NR. 2"
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 73, DATË 23.12.2025, "PËR MIRATIMIN BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026 DHE PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028"
Pika 7.	PËR MIRATIMIN E SHKËMBIMIT TË PRONËS NË ZBATIM TË VKM-SË NR.597, DATË 14.9.2022 "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E PLANIFIKUAR PËR RINDËRTIM, SIPAS PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE PËR 5 BANESA KOLEKTIVE, NË BASHKINË DURRËS" SI DHE VKM-SË NR.767, DATË 19.12.2025 "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM SPITALLË, BASHKIA DURRËS NË KUADËR TË PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE "MIQËSIA" DHE "AZEM HAJDARI" LOTI II-RRUGA "MIQËSIA"

Pika 8.	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 7 TË TABELËS SË OBJEKTEVE PËR PËRFORCIM MIRATUAR ME VKB-NË NR.141, DATË 12.11.2021 "PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TABELËS SË OBJEKTEVE PËR PËRFORCIM, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.137, DATË 28.10.2021"
Pika 9.	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË PALLATIT KASTRATI, NR.14 RRUGA "RAMADAN VELIU"

Keni ndonjë koment?
Jeni dakord me rendin e ditës?
Kalojmë në votim?

....U prish sistemi i votimit elektronik...

Denisa Luarasi : Sa ta rregulloj IT e bashkisë, kalojmë në votim me kartona.
Kush është pro, kundra, abstenim?
Me 34 vota pro, miratohet rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Përshëndetje të gjithëve.
Komisioni ynë e miratoi pikën e parë dhe fton Këshillin që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonja Edlira Harizi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale, Barazisë Gjinore dhe Kundër Diskriminimit, pasi shqyrtoi listën e familjeve që marrin ndihmë ekonomike për muajin korrik 2026, brenda fondit limit 6% dhe fondit të të ardhurave të Bashkisë, e miratoi atë dhe ia kalon Këshillit për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Harizi.
Komente ose pyetje për pikën 1, të rendit të ditës?
Nuk ka. Kalojmë në votim.
Kush është pro? Kundër? Abstenim?
Me 34 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, pikën e dytë ne, si komision, e miratuam me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin që të japë votën pro.
Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonja Edlira Harizi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale, Barazisë Gjinore dhe Kundër Diskriminimit, me shumicë votash, e kaloi për votim në Këshill, por personalisht rezervoj të drejtën, në bazë të rregullores së Këshillit, të një diskutim që e kam bërë edhe dje në mbledhje, si dhe për disa pyetje.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Harizi.
Ka komente ose pyetje për pikën dy?
Po, Muka.
A... kujtova nga ajo që s'mora.
Kërkoje, të lutem.
Po.

Edlira Shemsi: Atëherë, një diskutim të shkurtër në lidhje me projektplanin për vitet 2026–2030 për barazinë gjinore. Unë diskutova edhe në mbledhjen e kaluar në fakt, bëmë disa pyetje edhe në mbledhjen e kaluar, por po bëj një diskutim të shkurtër edhe tani.
Ky plan është nuk duhet parë si një debat ideologjik, pasi aty kërkohet që të ndihmohen gra, vajza, por edhe shtresa të tjera sociale që kërkojnë ndihmë dhe suport nga bashkia, për problemet e dhunës, për problemet e tyre ekonomike apo për t'u suportuar në nismat e tyre për sipërmarrje, biznes dhe aktivitete të tjera. Kështu që nuk e shoh si një debat ideologjik, por është një detyrim ligjor dhe moral për të garantuar që çdo grua dhe çdo burrë që të ketë mundësi të barabarta para ligjit për të jetuar, për të punuar dhe për të kontribuar si i barabartë në shoqëri.
Në nivelin vendor, unë këtë e shoh të përkthehet në politika, në më shumë politika konkrete dhe shërbime reale për qytetarët, jo vetëm si një dokument strategjik që do ngelet në letër.
Edhe herën tjetër unë thashë që, pasi lexova relacionin, aty është thënë në një pikë se akoma nuk është dhënë gjithë kosto. Vazhdon procesi i kostimit se sa do të jetë vlera financiare e zbatimit të këtij plani dhe bëra pyetjen: ku do të gjenden burimet financiare, për aq kohë sa nuk është bërë kostimi përfundimtar i tij?
Gjithsesi, unë besoj dhe shpresoj që të gjenden të gjitha burimet, në mënyrë që ky plan të realizohet dhe të mos mbetet në letër.
Roli i bashkisë është thelbësor në mbështetjen e grave dhe të vajzave, pasi specifikisht ky projektplan ka kryesisht këtë kategori gratë dhe vajzat që janë në vështirësi sociale dhe ekonomike. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet, mendoj unë, nënave kryefamiljare, të cilat janë të vetme, rrisin fëmijë jetimë dhe mbajnë barrën ekonomike apo përgjegjësinë e vetme për rritjen e fëmijëve.
Për këto familje nevojiten politika më të mirëmenduara dhe më aktive, edhe për punësimin e nënave, ashtu edhe për mbështetjen sociale, por edhe akses për fëmijët e tyre në çerdhe, kopshte apo programe që krijojnë mundësi reale për vetëpunësim dhe për integrimin e tyre ekonomik në shoqëri.

Po aq e rëndësishme është edhe mbështetja për familjet që kërkojnë ndihmë ekonomike, edhe pse janë të dy kryefamiljarët prezent në familje.
Bashkia duhet të jetë një institucion më pranë qytetarëve, duke identifikuar rast pas rasti këto që kanë nevojë për mbështetje sociale, duke ofruar ndihmë sa më të shpejtë dhe të koordinuar bashkë me institucionet e tjera që janë përgjegjëse dhe që ndërhyjnë në mbështetjen e tyre, në mënyrë që asnjë familje të mos mbetet dhe të mos ndihet e pambështetur.
Një prioritet i padiskutueshëm duhet të mbetet parandalimi dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave, apo dhe i dhunës në familje, sepse ndonjëherë, në raste të veçanta, mund të kemi edhe burra të dhunuar, edhe pse janë raste ekstremisht të rralla.
Çdo rast duhet të trajtohet me seriozitet maksimal, përmes atyre mekanizmave funksionalë të referimit në bashki, në të gjitha drejtoritë përkatëse të bashkisë, por edhe në institucionet e tjera, për të marrë mbështetje psikologjike, sociale por edhe ligjore edhe bashkëpunimi këtu do të jetë patjetër edhe me Policinë e Shtetit, si edhe me institucione të tjera ligjore, që do të jenë në ndihmë të këtyre grave të dhunuara.
Viktimat, sigurisht, nuk do të kenë nevojë vetëm për mbështetje psikologjike dhe sociale, por edhe për t'u ofruar atyre programe të mirëfillta të punësimi, në mënyrë që ato të jenë të integruara në jetën komunitare.
Integrimi i menjëhershëm në shoqëri duhet të jetë patjetër ai fokusi kryesor i objektivit të këtij projektplani për çdo rast që do të trajtohet. Ç'ka nënkupton, siç thashë, punësimin dhe strehimin pasi herën e kaluar unë bëra një pyetje: nga 300 gra të dhunuara, gati gjysma e tyre kanë kërkuar mbështetje edhe për strehimin, por vetëm tetë janë ndihmuar. Kjo bën që një pjesë e tyre të vazhdojnë të jetojnë nën një çati me dhunuesin. Një pjesë e tyre, patjetër, duhet të ndihmohen edhe në formimin profesional dhe jo vetëm me mbështetje psikologjike, por që ato thashë të integrohen në shoqëri duke qenë të punësuara dhe dukeqëne pjesëtare të barabarta të komunitetit, bashkë me të gjithë të tjerët, e të mos ndihen si raste që janë vetëm për mbështetje sociale.
Dhe në fund, mendoj që suksesi i politikave për barazinë gjinore nuk matet vetëm me 60 faqet e këtij projektplani, por sigurisht duhet të mbështetet në raste reale ndihme për gratë e dhunuara, vajzat e dhunuara, ato që kërkojnë mbështetje ekonomike, dhe për familjet në varfëri dhe në ndihmë ekonomike, apo për viktima të tjera të dhunës dhe intimidimit në shoqëri.
Mendoj që këto duhet të jenë prioritetet dhe unë shpresoj me zemër që të gjitha këto prioritete të arrihen dhe të ndihmohen sa më shumë gra dhe vajza, apo familje dhe shtresa që janë vulnerabël dhe që kërkojnë mbështetje nga bashkia. Faleminderit për diskutimin.
Tani kam edhe pyetjet.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Edlira Shemsi: Gjithmonë mendoj se jam brenda rregullores. Në relacion herën e kaluar ne bëmë debate dhe nuk e kaluam, nuk e miratuam, si anëtarë të opozitës, pikën që kishte të bënte me pjesën gjinore, pasi aty ishte një mjegullnajë në termin e transformimit gjinor. Ç'donte të thoshte ai term?
Dhe tashmë është hequr ky term fjalë për fjalë, por janë bërë sofizma fjalësh sipas mendimit tim, janë bërë sofizma fjalësh. Janë shtuar rreshta të tërë për të interpretuar ato që ne i kundërshtuam

herën e kaluar. Në relacion përdoret termi "qasje transformuese gjinore". Dhe çfarë duhet të transformojë realisht ky projekt, ky program i bashkisë? A kemi shembuj në praktikë që ne kemi ndihmuar në këtë transformim gjinor? Si kuptohet kjo?
Unë edhe dje në komision bëra një shembull të thjeshtë. Thashë :.. ç'domethënë "qasje transformuese gjinore" domethënë që rolin e kryefamiljarit e ka gruaja, por e ka edhe burri dhe duke qenë se edhe në ligjin shqiptar lejen e lindjes e merr dhe gruaja edhe burri, ligji këtë e ka sanksionuar, nuk ka ngel ta sanksionojë bashkia.

Denisa Luarasi: Ju lutem, pyetjen, jo diskutim. Bëni pyetjen.

Joniada Musaraj : Ka ardhur relacioni i ri.

Edlira Shemsi: E kam lexuar. E kam lexuar fjalë për fjalë. Jam bazuar në relacionin e ri. Kam qenë dje edhe në mbledhje dhe e kam marrë edhe të printuar relacionin. Mbi atë relacion po bazohem, mbi të riun. Mbi të riun. Absolutisht po. Merreni dhe lexojeni gërmë për gërmë. Mbi të riun po flas. Jo, jo, zonja Musaraj, flas mbi të riun.

Denisa Luarasi: Zonja Harizi përqëndrohu tek pyetja.

Edlira Shemsi: Kur flitet për transformimin e normave shoqërore, cilat norma konsiderohen problematike dhe si do të vendoset për transformimin e këtyre normave? Si transformohen ato?
Në dokument flitet për transformimin e roleve tradicionale gjinore. Cilat janë këto role tradicionale dhe ku do të ndërhyjë bashkia?

Denisa Luarasi: Ku është pyetja ?

Edlira Shemsi: Po, pyetje është. Është pyetje për drejtorinë përkatëse. E kam bërë dje në komision dhe kam gjithë të drejtën, në bazë të rregullores, ta bëj edhe këtu, në Këshill, këtë pyetje.
Në relacion thuhet disa herë plani nuk e ndryshon përkufizimin e gruas, burrit apo familjes. Nëse ky plan nuk i ndryshon këto, atëherë pse është parë e nevojshme të përsëritet disa herë sqarim?
Nëse plani nuk sjell asnjë ndryshim konceptual, po pse është parë e nevojshme të futen terma të rinj, të cilët nuk përkojnë dhe me pas shoqërohen me një fjalor me dhjetëra fjalë e faqe për të shpjeguar se çfarë janë këta terma?
Në një dokument strategjik duhet që çdo fjalë të jetë e kuptueshme, jo vetëm për këshilltarët, por për çdo qytetar, dhe nuk duhet të ketë nevojë për interpretim apo fjalor. Unë kështu e konceptoj.

Denisa Luarasi: Ja t'ja japim administratës ta sqaroj…

Edlira Shemsi: Pyetja e fundit, ju lutem. Përse janë përdorur terma si "marrëdhënie gjinore", "perspektivë gjinore", "qasje transformuese gjinore", kur këta terma nuk janë të përkufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në legjislacionin shqiptar?

Sigurisht, aty është cituar se jemi bazuar në relacione dokumenta dhe metodologjinë e organizmave evropianë, si UN Women, EIGE si ky komisioni për barazinë gjinore europian, dhe cilat janë burimet e ligjit shqiptar. Po cilat janë burimet në ligjin shqiptar?
Herën e kaluar unë bëra një pyetje të drejtpërdrejtë dhe zonja, më pas, e mbështeti përgjigjen dhe tha se jemi bazuar edhe në ligjin shqiptar. I thashë: …A është bazuar në Ligjin nr. 64, të miratuar në vitin 2025 nga shumica e mazhorancës? Një ligj i kundërshtuar jo vetëm nga opozita, por edhe nga institucionet fetare dhe shumë shoqata të tjera. Përgjigjja ishte po. Ndërkohë, ai ligj nuk është i cituar në relacionin e ri.
Këto janë pyetjet e mia.
Unë mendoj se janë bërë sofizma fjalësh, por thelbi mbetet i njëjtë. Kështu që në këtë kuptim unë them që ka akoma mjegullnaj dhe në këtë drejtim unë e jap votën time kundër. Ashtu e dhashë në komision në këtë pikë.

Emiriana Sako: E nderuar këshilltare, si fillim, ky plan është hartuar me ekspertë të organizatës ndërkombëtare UN Women, të cilët financohen nga Qeveria Shqiptare dhe nuk është hera e parë që bë jmë një plan të tillë. Kemi bërë një në vitin 2018, kemi bërë një në vitin 2022. Pra, është një proces dhe një detyrim ligjor, të cilin Bashkia e Durrësit e ka për detyrim ta sjellë në Këshillin Bashkiak për miratim.
UN Women ka në Shqipëri që në vitin 2007 që japin konsulencë të vazhdueshme dhe Bashkia e Durrësit ka qenë një ndër bashkitë e para që ka ngritur strukturat që në 2009, sa i takon shërbimeve sociale dhe dhënies së shërbimit në territor. Së dyti bazohet në Kartën Europiane të barazisë gjinore dhe në Këshillin e Bashkive të rajoneve të Europës, të cilët kanë rreth 2000 anëtarë të aderuar, 36 shtete, ndërto është dhe Shqipëria dhe 14 bashki janë nga Shqipëria, ndërto është dhe Bashkia e Durrësit. Ju thatë: "Si do të maten këto?"
Ju nuk keni informacion. Pra, flisni pa pasur informacion se çfarë shërbimesh jepen në Bashkinë e Durrësit. Po ju jap disa shifra nga raportet e vitit 2025. Janë shtatë qendra në Bashkinë e Durrësit që japin shërbime, dhe katër janë hapur vetëm gjatë mandatit që unë drejtoj Bashkinë e Durrësit. Në Bashkinë Sukth dhe në Bashkinë Rrashbull, përpara reformës territoriale, as nuk mendohej që të jepej shërbim social kur drejtonte partia që ti përfaqëson. Sot, në këto njësi administrative jo vetëm që jepet shërbim, por jo vetëm që janë ngritur strukturat, por marrin shërbim edhe qindra qytetarë, të cilët janë vendosur aty.
Atëherë, për vitin 2025, Qendra Komunitare Sukth ka ofruar shërbime për 352 qytetarë.
Qendra Komunitare Multifunksionale Nishtulla ka pasur 427 përfitues.
Qendra Komunitare Multifunksionale Rrashbull ka pasur 604 përfitues.
Qendra "Fuqizojmë Komunitetin", për vitin 2025, ka arritur në 849 përfitues, ku 223 qytetarë kanë marrë shërbime të drejtpërdrejta sociale, ndërsa 626 të tjerë janë bërë pjesë e aktiviteteve komunitare, informuese dhe ndërgjegjësuese.
Qendra e Emergjencës ka 39 përfitues për vitin 2025.
Bashkia e Durrësit, gjithashtu, gjatë vitit 2025 ka mbështetur me pagesën e aftësisë së kufizuar 3.500 individë dhe 697 kujdestarë; persona të verbër 862 persona dhe 238 kujdestarë; paraplegjikë dhe tetraplegjikë 391 persona dhe 384 kujdestarë.
Ndihmë ekonomike kanë përfituar 326 familje, dhe sigurisht edhe pjesa tjetër nga fondi social.

Për mbrojtjen e fëmijëve, gjatë vitit 2025 është ofruar Njësia e Shërbimit Social në Bashkinë e Durrësit ka ofruar mbrojtje për 245 fëmijë në nevojë mbrojtje, përmes koordinimit të shërbimeve psikologjike, sociale, ligjore, arsimore dhe shëndetësore.
Në vitin 2025 janë trajtuar 339 raste të dhunës në familje dhe, sigurisht, duke u bazuar te plani që shkoi në dhjetor, ne miratuam, për herë të parë, bashkia e parë në Shqipëri, e cila do të japë grantin e menjëhershëm për bonusin e qirasë, të financuar 100% nga Bashkia e Durrësit, për gratë të cilat janë pre e dhunës në familje, pa pasur nevojë që miratimi të vijë në Këshillin Bashkiak.
Pra, ne kemi miratuar këtu, me votën e të gjithëve ju, që ajo grua apo ai burrë i cili është pre e dhunës në familje të ketë mundësinë, brenda 24 orëve, të largohet nga banesa apo nga dhunuesi.
Nga ana tjetër, gjatë vitit 2026, në Rrashbull ka pasur, për gjashtëmujorin e parë, 273 përfitues; në Nishtullë 370; ndërsa Qendra "Fuqizojmë Komunitetin" ka pasur 578 përfitues.
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës ka administruar 302 raste, ndër të cilat 57 janë raste të shtuara këtë vit. Këtu jepet mbështetje psikologjike, ndihmë juridike falas, regjistrim në çerdhe, kopshte e të tjera me radhë.
Në të njëjtën periudhë janë trajtuar 70 raste të dhunës në familje, nga të cilat 51 gra dhe 19 burra, për interesin tënd të veçantë.
Një komponent tjetër i rëndësishëm i mbështetjes sociale janë edhe programet e strehimit social, ku gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 janë mbështetur me bonus qiraje 356 familje, e nderuar këshilltare, ku përfitues të drejtpërdrejtë janë 203 fëmijë.
Tani ky plan nuk ka asnjë element, të gjitha ato terminologji që t'i përdoret, transformim gjinor e të tjera me radhë, asnjë element në kundërshtim e legjislacionin shqiptar në fuqi. Ne këtu jemi Këshill Bashkiak, nuk jemi Parlamenti që të diskutojmë ligjin ne veçanti. Kështu që ky plan gjithashtu është një element tjetër shumë i rëndësishëm përsa i takon, do preferoja të më shikonit në sy në fakt, po e kuptoj që e ke të vështirë. Ky plan gjithashtu është një instrument shumë i rëndësishëm për grantin që merr bashkia Durresit nga qeveria shqiptare. Pra, në një sistem pikëzimi që është vendosur për çështjen e transfertave, ne do të kërkojmë që me miratimin, me planin e miratuar do të marrim rreth 9.5 milion lekë më tepër. Me planin e refuzuar nga këshilli do ta humbim këtë mundësi gjithmonë për t'i dhënë shërbim qytetarëve Durrësit.
Shumë faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, kryetare.

Emiriana Sako: Jo, nuk ka replikë tani. Ti fole, unë fola.

Denisa Luarasi: Jo, të lutem. Nuk ka replikë. E ka kërkuar fjalën.....

...Flasin pa mikrofon...

Edlira Shemsi : Nuk i mohoj faktet që përmendët. Sa nga gratë e dhunuara kanë kërkuar ndihmë për strehim dhe për ndihmë ekonomike? Sa prej tyre, zonja kryetare? Më thoni shifra.
Meqë thatë se unë nuk jam informuar, unë jam informuar dhe nuk i rrëzoj ato shifra që kanë shkuar për aktivitete dhe për mbështetje psikologjike.

Denisa Luarasi: Zonja Harrizi e morët përgjigjen ju ftoj në votim elektronik.

Edlira Shemsi: Jo, zonja kryetare, mos ma ndërprit fjalën. Nuk ke të drejtë, të lutem.
Nuk ke të drejtë.
Sa gra kanë marrë mbështetje ekonomike?

Emiriana Sako: Në këto aktivitete janë mbështetës me emër e mbiemër? Ta thashë pak më parë. Mbaj shënim kur flas unë.

Edlira Shemsi: Po sa prej tyre janë punësuar? Sa prej tyre janë ndihmuar për të nisur biznese, që të ndihen të integruara në shoqëri? Jo thjesht të shkojnë te psikologu, sepse psikologu më i mirë është kur ato integrohen, kur i punëson, kur u krijon kushtet e strehimit.
Dhe sa për invalidët që ju përmendët, shumë mirë që...

Denisa Luarasi: Kalojmë në votim.
.....votimi ndërptitet....Muka kërkon fjalën.....
Po Muka.

Ardian Muka: Atëherë mirëdita !
Për të bërë replikë...
Për ato që është natë "Mirëmbrëma" për ne është ditë sot.
Për të bërë një replikë me fjalën që mbajti zonja kryetare. Me të drejtë i referohet që ne kemi bërë dy plane në 2018 dhe në 2022. Por po na vjen një plan i ri në 2026-ën dhe kemi një ndryshim thelbësor. Kemi kalimin e Ligjit nr. 64, datë 16.11.2025, i cili ka futur koncepte komplet të ndryshme nga ato që kishte ligji i vitit 2015 për sa i takon barazisë gjinore dhe koncepteve kryesore ku ato futen ka lidhje me gjithë diversitetin seksual dhe gjinor.
Tani është e vërtetë që Bashkia e Durrësit ka dhënë shumë shërbime sociale si bashki fondin social, asistencën për fëmijët, për dhunën në familje, asistencën për strehimin social. Dhe, me thënë të drejtën, dhe ky plan do të kisha shumë dëshirë që të shkonte në këtë linjë sikurse ka shkuar edhe më përpara. por koncepti më përpara ka qenë shumë i thjeshtë. U diskutonte për gra të dhunuara, u diskutonte për gra të trafikuara, për gratë në pamundësi dhe burra njëkohësisht. Ndërkohë që plani që na u paraqit herën e kaluar dhe që ne votuam kundra, kishte dhe koncepte me thënë të drejtën të bazuara në ligjin 64/2025 përsa i takon koncepteve të reja. Pra ishte futur dhe koncepti i LGBT-së si dhe konceptet që kanë lidhje me ligjin në të gjithë diversitetin e tyre gjinor. Pra në ligjin, në planin e ri që na keni prurë si ndofta keni reflektuar për atë që neve kemi folur, por nuk keni kuptuar konceptin e asaj çfarë ne kemi kërkuar, sepse nga plani është hequr fjala LGBT, ndërkohë që kjo është një shkelje ligjore, sepse ligji dhe të gjitha konventat ku është bazuar ligji janë të shprehura shumë qartë përsa i takon kësaj çfarë unë do them më poshtë. Atëherë, plani vendor për barazinë gjinore në bashkinë e Durrësit do të theksoja që bazohet sipas relacionit të bashkisë në Konventën dhe Kartën Europiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, VKM-në 64/2025, datë 16.11.2025 "Për

barazinë gjinore” dhe VKM-n 68/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe për mendimin tim jam në kontradiktë me atë çfarë serviret në këtë plan. Konventa europiane në të cilën bazohet dhe kërkon të përafrohet dhe legjislacioni ynë përkatësisht ligji 64/2025 për barazinë gjinore nuk është një dokument i vetëm por një grup interes instrumentash kryesore ligjore në kuadrin e Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian. Kategoritë kryesore që përfshihen në politikat e barazisë gjinore nuk dallohen më në dallime biologjike, por tek përkatësia gjinore dhe fushat e ndërthurjes, pra tek interseksionaliteti. Kategoritë e targettuara dhe të mbrojtura përfshijnë sipas përkatësive gjinore gratë dhe burrat si dy kategori kryesore tradicionale me fokus parësor tek barazia e mundësive në jetën politike, ekonomike, sociale dhe shoqërore, grupet shoqërore.
Jam në emër të grupit jam në emër të grupit.

Flutura Kasa: Në emër të grupit ja le doktoreshës.
O, Denisa, jemi në orën e edukatës morale? E kemi bërë 9-vjeçaren. Edukatë 40 minuta për një pikë. O zotëri, nuk është...

Ardian Muka: Zonja kryetare, ka mundësi të vendosni rendin, të lutem?

Flutura Kasa: Po çfarë rendi? Ti na çmende.

Ardian Muka: Grupet shoqërore në nevojë të ndërthurura, ku të drejtat zbatohen mbi kategoritë që vuajnë nga diskriminimi i shumëfishtë, interseksionaliteti dhe margjinalizimi.
Individët sipas identitetit gjinor. Kuadri evropian mbron gjithashtu kategoritë që përjetojnë diskriminim në bazë të identitetit gjinor, duke përfshirë personat transgjinorë dhe moskonformistët gjinorë.
Bazuar sa më sipër, në legjislacionin tonë, Ligjin nr. 64, ligjvënësit janë përpjekur ta përafrojnë legjislacionin tonë me atë evropian, përmbylljen e kapitujve ku neve kërkojmë të hyjmë në Europë. Neni 4, pika "a", thotë: "Barazia gjinore janë të drejta, përgjegjësi, mundësi, pjesëmarrje dhe përfaqësim i barabartë i grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre."
E theksoj...

Denisa Luarasi: Nuk ka lidhje fare me këtë tani Muka.

Ardian Muka: Po më lini ta mbaroj, ju lutem.
"...në të gjitha fushat e jetës, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejta dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëlloj nga arritjet dhe zhvillimet e shoqërisë, në respektim të dallimeve biologjike, shoqërore, kulturore, interesave, nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme sipas përkatësisë gjinore". Kështu thotë ligji shqiptar.
Neni 12 i po këtij ligji, për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, pika 1, thotë:
"Institucionet publike sigurojnë zbatimin e politikave të barazisë gjinore, duke përfshirë interesat, prioritetet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, nëpërmjet zbatimit të integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në procesin e planifikimit, menaxhimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave buxhetore, si dhe programeve,

planeve dhe projekteve të zbatimit të tyre, me qëllim shpërndarjen mbi bazën e nevojave specifike gjinore të burimeve."
Bazuar sa më sipër, po ju citoj grupimet gjinore dhe orientimet seksuale të njohura nga konventat evropiane dhe për efekt të Ligjit nr. 64, edhe në Shqipëri, automatikisht edhe nga Bashkia e Durrësit definicion...

Rolant Xhelilaj: Ta ndihmoj pak, mos lodhet?
Një sekond.

Ardian Muka: Ju lutem, zoti Xhelilaj, kur ta merrni fjalën, unë do t'ju dëgjoj me gjithë respektin e mundshëm.

Rolant Xhelilaj: Jo, jo nuk je duke folur për pikën. Prandaj.

Ardian Muka: Jam duke folur për pikën dhe po ju sqaroj, të lutem, që relacioni që na ka ardhur...

Rolant Xhelilaj: Muka, të lutem, një minutë.
Ndërpritja mikrofonin.

Ardian Muka: ...është një lëkurë deleje mbi kurrizin e ujkut. Domethënë, në qoftë se deri sot ne kemi bërë plane për zonja dhe zotërinj që kanë qenë në nevojë, sepse kanë qenë të dhunuar, të persekutuar, në pamundësi apo të trafikuar, sot përfshihen edhe të gjitha kategoritë që unë do t'i lexoj më poshtë, në bazë të Konventës Evropiane dhe në bazë të Ligjit nr. 64.

Rolant Xhelilaj: Me leje, por nuk ka nevojë t'i lexosh. Ti je kundër. S'ka nevojë t'i lexosh

Ardian Muka: Herën e fundit ju thashë se ishin 41 kategori. Në fakt, isha gabim, sepse janë 46 kategori, të cilat do të përfitojnë nga barazia gjinore

Rolant Xhelilaj: Aq më mirë, aq më mirë .....

Ardian Muka: .....dhe, më poshtë, do t'jua lexoj tashi. Jo për ju, se besoj i dini, por për publikun.

Rolant Xhelilaj: Denisa 3 minuta ka drejtë ai.

Ardian Muka: ... Kategoritë janë: burra, gra, homoseksualë, lezbike, androgjinë, gej, bigjender...

Denisa Luarasi: Muka ka kaluar koha. Të lutem, përndryshe do ta mbyll mikrofonin.
Përmblidhe, të lutem.

Ardian Muka: Po e përmbledh. Femra, meshkuj, meshkuj-femra, gjini të ndryshueshme, genderquers,interseksualë, pa gjini, aseksualë, jobinarë, gjithëgjinorë, panseksualë, transmeshkuj,

transburra, transfemra, transgra, transnjerëz, transgender*, trans*femër, trans*njerëz, transeksualë, ndërfemërorë, ndërmashkullorë, ndërburra, ndërgra, ndërnjerëz, ndërgjinorë...

Denisa Luarasi: Muka do ta mbyll mikrofonin .
Fjlën e ka kryetari i grupit të Partisë Socialiste.

….. *shumë zhurmë në sallë…..*

Florian Tahiri: Një sekond të flasë unë.
Përshëndetje.
Atëherë, sikurse isha javën e kaluar dhe kishim mundësi te mbledhja e kaluar, që u kalua plani i barazisë gjinore dhe unë votova abstenim, mbas takimit me përfaqësuesit e shërbimit social dhe ku u shpjegua pse unë votova abstenim ishte për shkak të termit "transformim gjinor", që normalisht në terminologjinë dhe ne shqiptarët ndoshta nga përkthimi i huaj për ne vret veshin shumë, sepse ne fjala transformim është diçka tjetër. Për mua si individ egzistojnë vetëm dy sekse mashkull dhe femër siç na ka bërë zot të parët që shkojnë te gjinekologu, të dytët që shkojnë te andrologu, ndërsa të tretat shkojnë te psikologu apo te doktoreshë Edlira. Ideja është e tillë kjo terminologji transformim gjinor u modifikua, pra u hoq nga plani, dhe unë sot dhe gjithë ky terminologji u zëvendësua, pra për ato që s'kanë dijeni, mbështetet në një qasje që adreson shkaqet strukturore dhe institucionale të pabarazive ndërmjet grave dhe burrave, duke synuar jo vetëm fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave dhe vajzave, por edhe përmirësimin e politikave publike, shërbimeve vendore dhe praktikave institucionale që mund të prodhojnë ose të riprodhojnë pabarazi. Kështu që duke me këtë ndryshim unë sot e votoj pro kur të vijë momenti i votimit. Faleminderit.

…..*Flasin nga salla…..Edlira flet pa mikrofon ....*

Rolant Xhelilaj: Me leje, me leje. O doktoresha, doktoresha Edlira, Eda, Eda, një çikë respekt për Këshillin Bashkiak, një çikë respekt.
Ja, ma lër ta them unë, edhe për ty, edhe për mikun tim Mukën, që në nisje ai thotë: "Ky vendim që paraqet sot Këshilli Bashkiak mbështetet te filani, filani dhe te Ligji nr. 64". I ka përfshirë të gjitha brenda me këtë mbështetje dhe në relacionin që ka paraqitur ka vendosur piketat kryesore, në të cilat Bashkia e Durrësit mendon vëmendjen e saj për vitin 2027.
Të gjithë komentet që bëni ju këtu janë leksion politik. Të vazhdosh në linjën e atyre që të përfaqësojnë atje lart në Kuvend, që me përpjekjet e tyre nuk arritën dot ta rrëzojnë këtë ligj.
Ky është ligj që funksionon në Republikën e Shqipërisë. I përfshin të gjitha ato kategori. Ka atë qëllimin që e theksuat ju për përafrimin e ligjeve shqiptare me BE-në, ku ne synojmë të hyjmë.
Të gjitha diskutimet kanë vetëm karakter për t'u dukur dhe karakter politik.
Bjeri shkurt dhe thuaj: "Derisa mbështetet te Ligji nr. 64, i ka të gjitha brenda dhe bashkia zgjedh atë fokusin për një vit dhe nuk përjashton asgjë nga Ligji nr. 64".
Gjithë gjërat e tjera pasqyrohen në votim.

Teoritë me nga 10 minuta, zonja kryetare, janë jo korrekte. Ne s'kemi nevojë të dëgjojmë nga zoti Muka, me gjithë respektin, se neni kaq, se pika kaq, se kjo lexohet kështu, se kjo thotë ashtu.
Të gjithë i kemi ligjet përpara, i lexojmë dhe gjithkush i kupton me aq sa ka mundësi dhe me dëshirën që ka për të kuptuar. Të tjerat pasqyrohen në vendimmarrje, në votë. Teori s'kemi nevojë.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Rolant Xhelilaj: Në qoftë se më thua që në fillim, më fal, edhe një sekondë. Nuk ka nevojë fare për replikë, se s'ka replikë.
Në qoftë se të thuhet që në fillim se mbështetet në këtë bazë ligjore, janë të gjitha të përfshira brenda. Komentet janë teori konspirative pastaj.

Denisa Luarasi: Kalojmë në votim elektronik.
Me 27 vota pro dhe 6 kundër, miratohet pika 2 e rendit të ditës.
Atëherë...
Për replikë, dy minuta, ju lutem. Për replikë dy minuta Mukës.
Po, Muka, merr fjalën.
Të lutem, Edlira, vetëm qetësi.

Rolant Xhelilaj : Jo, s'ka kuptim, s'ka replikë.
Ai foli në emër të grupit, ai dha qëndrimin e grupit, dha dhe votën kundër dhe ça replike do bëj.

…..*Flasin pa mikrofon…..*

Ardian Muka: Po replikë, meqë zoti Xhelilaj më përmende emrin. Po të kishte thënë kolegu, s'kishe... Po të kishte thënë kolegu, jemi në rregull. Mësohuni të mos përmendni emrin ju, zonja Flutura, e kushdo tjetër.

Rolant Xhelilaj: …se the kryetaren...

Ardian Muka: Kryetarja... Kryetarja një është, nuk ka dy kryetare. Dhe megjithatë nuk e përmenda as me emër dhe as për denigrim. Thashë "kryetarja", sepse kryetaren kemi.
Atëherë, më lejoni, më lejoni dy minutëshin.
Natyrisht, duha të shpreh votën kundër, që ne e shprehëm edhe me votë, por nga ana tjetër, me këtë kalim që i keni bërë këtij ligji, nuk i keni dhënë të drejtën vetëm grave dhe burrave të dhunuar, atyre që janë në nevojë, por i keni dhënë të drejtën edhe atyre 46 kategorive, që unë përmenda më sipër, të cilat, në bazë të ligjit... dhe ligji është i gabuar, por ne nuk duhet të binim në atë batak. Le të rrinim dhe të thonim vetëm gratë dhe zonjat, të paktën këtu në bashkinë tonë.
Do t'ju dënojë, besoj, historia. Uroj që të mos ju ndodhin ato që i ndodhën Elon Musk, por kur i ndodhi atij, imagjinojeni se çfarë rreziku jemi ne të gjithë të tjerët, që fëmijën ia morën dhe ia kthyen në transgjinor atij. Imagjino çfarë rreziku jemi ne të gjithë të tjerët.

…..Flasin pa mikrofon…..

Denisa Luarasi: Kalojmë te pika 3.
Ju faleminderit.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 3,** Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Të hyjmë njëherë në BE, pastaj le të na marrë historia ne, zoti Muka.
Komisioni e votoi pikën e tretë dhe fton Këshillin që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zotit Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli: Përshëndetje.
Edhe komisioni jonë ra dakord dhe fton Këshillin ta votojë.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Xhongoli.
Komente, pyetje ka për pikën 3 të rendit të ditës?
Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.
Me 33 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 3 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4,** Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Komisioni jonë pikën katër e miratoi me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni ynë e kalon këtë pikë për miratim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Xhelilaj.
Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian, zoti Luan Nezha.

Luan Nezha: Përshëndetje.
Komisioni u mblodh dhe e kalojmë me votat e shumicës.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zoti Nezha.
Komente, pyetje ka për pikën 4 të rendit të ditës?
Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.

Me 33 vota pro, miratohet edhe pika katër e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 5**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën pesë ne si komision e votuam pro dhe ftojmë Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e kalon në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Xhelilaj.
Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonja Mirela Shala.

Mirela Shala: Përshëndetje.
Edhe komisioni ynë e miratoi dhe fton Këshillin për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Shala.
Kalojmë votim. Komente, pyetje ka? Më falni.
Ok, kalojmë në votim.
Me 33 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 5 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 6,** Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën gjashtë ne e miratuam dhe ftojmë Këshillin që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Komisioni jonë unanimisht ishte dakord për kalimin e kësaj pike, dhe për rëndësinë e saj në mbledhje dhe për miratimin e këtij projektvendimi.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zoti Xhelilaj.
Komente, pyetje ka për pikën 6 të rendit të ditës?
Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.
Me 33 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 7**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën shtatë ne si komision e votuam pro dhe ftojmë Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.
Komisioni i Pronave Publike, pikën shtatë të rendit të ditës e kalon për votim në Këshillin Bashkiak me votimin e shumicës.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Markola.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje.
Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që pika shtatë të kalojë për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zonja Feshti.
Komente, pyetje ka për pikën shtatë të rendit të ditës? Po, Muka.

Ardian Muka: Me të thënë të drejtën, kisha një pyetje. Ku referoni për zonën e dëmtuar pikësore? Çfarë do të thotë në koncept "zonë e dëmtuar pikësore"?
Faleminderit.

Emiriana Sako: Pallate pikësore quhen ato objekte …
.... flet pa mikrofon....
....kanë të drejtën të rimarrin sipërfaqen në objektin e ndërtuar.Tani, normalisht, ato janë me VKM, pra janë nominale, edhe emrat dhe përfituesit përkatës, por ne i sollëm në Këshill sepse, së pari, është e nevojshme për pozicionimin e tyre, pra se ku do të vendosen. Në rastin e dyqaneve, në gjithë pronën e katit përdhe këto do të pozicionohen në këte pozicion le të themi ne një 1/4 sipërfaqes. Nesër, pasnesër, kur këto të jenë prona të Bashkisë, pra objektet e tjera të cilat janë ndërtuar aty, dy njësi shërbimi, të cilat ne do t'i kërkojmë qeverisë t'i përdorim për funksione shërbimi, si njësi administrative dhe bibliotekë për lagjen aty, do të bëjmë të mundur që ato të kalojnë në asetet e Bashkisë se normalisht, është Këshilli pronar i aseteve, kështu që për këtë arsye e sjellim në Këshill. Në një farë mënyre është edhe informim, por dhe pas kësaj ne do të dorëzojmë direkt dhe do të ndjekim procedurat përkatëse për dorëzimin e sipërfaqeve te subjektet përfituese.
Pallatet pikësore, pra objektet pikësore, janë pallate të cilat janë ndërtuar po atje ku ishin, sepse jo të gjitha kërkesat që ne kemi pasur janë miratuar për rindërtim në të njëjtin vend. Ato që janë miratuar janë quajtur, sipas PDyV, nga Plani i Detyruar Vendor apo aktit normativ, si pallate pikësore të vendosura në zona të ndryshme të qytetit, aty ku kanë qenë përpara tërmetit.

Ardian Muka: Me pas këto do shpërblehen do marrin siperfaqe, siperfaqa e tokës mbetet pronë e bashkisë?...

Emiriana Sako Një pjesë marrin sipërfaqe, ndërsa tek Azem Hajdari marrin apartament në të gjithë pallatin ku është ndërtuar godina, siç është Lura, Dakli. Ndërsa tek Azem Hajdari janë ndërtuar rrugë, është ndërtuar kanal dhe ato këtë praktikisht është shpronësim me këmbim, jo me pagesë. Do të marrin sipërfaqet në zonën e re të rindërtimit. Pra, nëse ka 300 m², do të marrë 300 m².

Denisa Luarasi: Faleminderit, kryetare.
Pyetje, komente të tjera ka?
Kalojmë në votim për pikën 7.
Me 33 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika shtatë e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 8**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën tetë ne si komision e miratuam dhe kërkojmë sot që Këshilli ta miratojë.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.
...E fiku... edhe njëherë, ju lutem..

Rolant Xhelilaj: Edhe Komisioni i Buxhetit e kalon pikën tetë për miratim në këshill.

Denisa Luarasi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe për pikën tetë, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që të kalojë për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Feshti.
Komente, pyetje ka për pikën tetë të rendit të ditës?
Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.
Me 33 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 8 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 9**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën nëntë ne si komision e miratuam me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin që të japë votën pro.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe për pikën nëntë, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që të kalojë për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Feshti.
Komente, pyetje ka për pikën 9 të rendit të ditës? Po, Muka.

Ardian Muka: Me thënë të drejtën, doja të përgëzoja për këtë pikë edhe pjesën e bashkisë, e cila ka reflektuar, falë edhe presionit pozitiv që gjatë gjithë kohës pjesa e opozitës ka kryer, përsa i takon dhënies së të drejtës së strehimit dhe këtyre personave të cilët kanë bërë blerje. Por siç e kemi ne shqiptarët kur bëjmë blerje nuk e bëjmë në emër të fëmijës, por e bën prindi dhe kemi nga dy apartamente ndofta kemi dhe një qendër tregtare, më fal një ambient shërbimi dhe në ato momente me ligjin ekzistues dhe me me VKM-të ekzistuese nuk e gëzonin dot të drejtën që të kishin kush kishte dy apartamente apo tre. Neve kemi qenë gjatë gjithë kohës që kush është është pronar i ligjshëm, meqënëse tërmeti i dëmtoi të gjithë, t'i jepet e drejta e pronës dhe t'i jepet e drejta e strehimit edhe atyre banorëve, të cilët kishin nga dy apo kishin dhe ambiente shërbimesh. Thashë, falë, uroj që të ketë qenë, falë edhe presionit pozitiv që opozita ka kryer, por thashë si akt besoj dhe uroj që bashkia ta ndjeki edhe për objekte të tjera ku të paktën pjesën e opozitës, votën tonë pro do ta ketë siç këtë rast dhe për rastet e tjera, kur do të diskutohet për këto raste, pra ku banorë kemi, nuk besoj që janë shumë në Durrës, por dimë te pallati VIP, megjithëse është zona, zona e njësive tregtare. Po aty një pjesë është pronar legjitim se ka qenë pronar trulli. Pjesa tjetër është pronarë të cilët kanë blerë. Pse mos t'i kthehet e drejta? Natyrisht ndofta ë është VKM-ja, por unë do sugjeroja që ne të dilnim si këshillë ndofta edhe me një vendim apo me një sugjerim për një rishpërndarje duke i dhënë të drejtën pronarëve për këto raste. Ka dhe raste të tjera me ç'di në zonën e Shkozetit t'i shqyrtonim ndofta rast pas raste që takon pjesës së bashkisë që të na e sjelli si propozim. Neve si opozitë do jemi bashkëpunues në këto vendime që do na vijnë në lidhje me këto materiale. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zoti Muka.
Po, Edlira, mund ta thërrisni mikrofonin.
Edlira, mikrofonin, sepse nuk dëgjohet.

Edlira Shemsi: Jo, unë kam zë edhe pa mikrofon, por, meqë m'u kërkua mikrofoni.
Duke qenë se është dhe kryetarja këtu, bëhet fjalë për pallatin 901 pranë shkollës "Naim Frashëri", besoj që ju e dini si problem. Atyre fillimisht u tha që do të meremetojnë banesat me fondin që do jepej. Pastaj u tha që ato ai pallat mund të shëmbej dhe së fundmi nga Instituti i Ndërtimit u vendos që do forcohen kolonat. Në ato pallat treçereku janë pensionist. Unë i njoh personalisht. Ato vazhdojnë paguajnë qira pasi bonus qiraje nuk kanë me ato pensionet e tyre. Ça do bëhet për pallatin e tyre? Si do shkojë puna, sepse është kthyer mbrapshtë nga Instituti i Ndërtimit që, po do bëhet forcimi i kolonave. Mundësisht domethënë të procedohet brenda mundësive sa më shpejt sepse thashë realisht janë pensionistë dhe vijnë herë pas here e pyesin dhe këtu në bashki, kanë kontaktuar dhe me juve zonja kryetare. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Edlira.
Kryetare mikrofonin.

Emiriana Sako: Ky objekt ka pësuar disa analiza të ndryshme nga Instituti i Ndërtimit. Njëherë ka qenë D3 dhe më pas nga vlerësimi doli që ishte mbi 70% për rindërtim. Pastaj u rishikua si vendim dhe konkluzionet e Institutit të Ndërtimit ishte që duhej riforcuar.
Ne kemi përfunduar projektin dhe kemi dërguar materialin në Këshillin Shtetëror të Rindërtimit. Është miratuar edhe aty, dhe besoj se në një rishikim të mundshëm që mund të kemi gjatë vjeshtës, mund të bëhet edhe buxhetimi, sepse realisht aty dëmet janë të konsiderueshme.

Denisa Luarasi: Faleminderit, kryetare.
Pyetje tjetër ka?
Kalojmë në votim.
Me 33 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 9 e rendit të ditës.

- Siç ju thashë edhe në krye të herës, ju ka ardhur me email një informacion nga Bashkia, drejtuar Këshillit nga kryetarja, dhe me dakordësinë tonë si Këshill do të marrim në shqyrtim çështjen e rindërtimit të rastit të objektit në rrugën "Ramadan Veliu".
  Si kryetare e Këshillit ngarkoj Komisionin Ligjor për ta zbardhur dhe për të marrë një vendim. Ngarkohet Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
  E bëra....

Emiriana Sako: Në vazhdim edhe të asaj që tha këshilltari Muka.
Ne kemi shqyrtuar tek ky objekt, pra objekti i rrugës "Ramadan Veliu",kemi shqyrtuar raste të cilat i kemi klasifikuar në bazë të Aktit Normativ nr. 9 si përfitues dhe më pas, me vendimin normalisht doli që ato miratohen. Ndërsa ditën e sotme në Këshill ju kemi sjellë një informacion për pjesën tjetër të banorëve të atij objekti, të cilët mund të kenë çështje, problematika të ndryshme apo specifika të ndryshme, të cilat ne nuk mund të marrim dot vendimin për propozimin për miratimi. Nisur nga situata faktike aty që, pra gjendja e apartamenteve është këto njerëz posedojnë nga një certifikatë pronësie, për arsye se mund të kenë prona të dyta në qytetin e Durrësit apo mund të mos jenë shtetas të shqiptarë ne nuk kemi mundësi t'i shqyrtojmë ja kemi sjellë këshillit për të marrë një vendim pra për të shprehur dakordësinë janë dakort apo jo që këto të të jenë përfitues, sepse kemi pasur dhe preçedencën.
Pra, aty kemi tre arsye. E para, akti normativ numër nëntë në nenin 21 thotë që duhet të përfitojnë të gjithë ata që kanë pasur shtëpi në qoftë se pallati ndërtohet po atje ku ka qenë. Së dyti, këtu investitori që ka pasur objektin përpara se të shembej, ka dhuruar një sipërfaqe prej 3.000 m² për banorët, në mënyrë që ata mos merrnin sipas aktit normativ, po të merrnin sipërfaqen ekzistuese që kanë patur. Dhe së treti kemi dy raste të cilat janë drejtuar gjykatës dhe kanë dalë fitues.
Tani ne për të shmangur këtë hapësirë pritje kohore për qytetarët që kanë pasur pronat aty më përpara, i kemi sjellë një relacion këshillit së bashku me problematikat e të gjitha rasteve nominale dhe kërkojmë nga ju një opinion, i cili patjetër do të dali në një vendim pro apo kundra për t'i shqyrtuar këto raste apo jo? Dhe sigurisht ne kemi pasur një rast preçedent që është bërë tashi

vitin nuk e kujtoj, por mbase në 2022 ose 2023 ku këshilli ka shqyrtuar drejtpërsëdrejti kërkesën e qytetarëve. Mendojmë që është një rast, i cili duhet parë hapur nga të gjithë këshilltarët dhe të dilet në një vendim që, kanë të drejtë këta sipas këshillit bashkiak apo jo për të përfituar banesat, që kanë pasur përpara tërmetit në të njëjtin objekt, sepse e theksoj që aty apartamentet janë parashikuar nga donatori, pra është investimi i realizuar nga UAE-ja, janë parashikuar si apartamente, por sot ata nuk mund t'i marrin, sepse nuk kanë një Vendim të Këshillit Bashkiak.
Kështu që është në dorën tuaj për të marrë një vendim, pastaj më tej sipas vendimmarrjes së këshillit ne do të vazhdojmë punën..

Ardian Muka: Zonja kryetare, këtë material tani po e shihja, me thënë të drejtën nuk kam arritur ta shoh, është i orës 10:40.
Megjithatë, ne e shprehëm atë që është opinioni jonë edhe në rastin paraardhës. Pra jemi pozitivë dhe do të shprehemi po, gjithmonë në këto raste kur diskutohet për banorët, aq më shumë kur ndërtohet në të njëjtin pozicion dhe kur nga ana e ndërtuesit apo zhvilluesit është vënë në dispozicion edhe kjo hapësirë, pra sipërfaqja që do t'u jepet këtyre banorëve. Pra nuk ndikon në asnjë moment në atë që është kasëm në pjesën e investimeve të Bashkisë. Jemi pozitivë.
Nga ana ligjore, besoj se ne sot do të japim në parim sot okej dhe kjo do të futet si pikë në rendin e ditës të mbledhjes tjetër, apo me aprovimin tonë do të kalojë si pikë.
Kjo do të duhet të dalë teknikisht.

Emiriana Sako *:* Do kaloj sot e miratoni. Me vendim nga ju.

Ardian Muka: E nxjerrim me vendim, pra do jetë si një pikë e veçantë në këtë rast, pra do shtohet si pikë e mbledhjes apo neve thjesht do japim opinionin që jemi pozitiv dhe kjo do shqyrtohet një moment tjetër?

Denisa Luarasi: E hedhim si dakordësi, e hedhim si votim që jemi dakord dhe pastaj e nxjerrim.

Ardian Muka: Jo, për interpretimin flas nga ana ligjore.
Se për dakordësinë e thamë, jemi dakord që edhe ata të marrin të drejtën.

Denisa Luarasi : Po ta sqarojmë pak.

Ardian Muka: Po, faleminderit.

Denisa Luarasi : Po, të flasë pak Drejtoresha Juridike.

Alneida Rroshi: Të nderuar këshilltarë.
Jemi para faktit që ne kemi kërkuar nga Këshilli Bashkiak, në këtë rast, për të dalë me një vendimmarrje, duke qenë se akti normativ për ne e ka kufizuar pak të drejtën për t'i bërë, për t'i kaluar dhe për të nxjerrë një strukturë për pronarët legjitimë që janë në rrugën Ramadan Velja, në njësinë numër 5. Ndodhur në këto kushte, duke qenë se propozimi nuk ka ardhur dot nga

Komisioni i Posaçëm, ku unë jam anëtare e Komisionit të Posaçëm, kërkojmë nga ana juaj që kjo vendimmarrje të merret nga Këshilli Bashkiak dhe më pas zbardhja e vendimit të bëhet po nga Këshilli Bashkiak.

..... *Flasin nga salla.....*

Alneida Rroshi Procedura, kjo është procedura.

Denisa Luarasi: Po, po. Thirre mikrofoni pra, prandaj nuk e shikoj.
Luani po.

Luan Nezha : Po, përshëndetje.
Edhe grupi im është pro dhe, duke qenë që është edhe kryetarja e bashkisë këtu, do doja që, përveç këtyre rasteve dhe rasteve të tjera, të mbyllet sa më shpejt procesi i rindërtimit, sepse më 26 nëntor të këtij viti bëhen gati shtatë vjet zyrtarisht. Duke qenë që qytetarët e Durrësit, si në qytet ashtu edhe në rrethina, jo e presin, por e presin ndoshta sepse mbas shpirtit është prona. Duke qenë që jo vetëm në këtë rast, unë jam edhe me kolegen Flutura, ku diskutojmë ndonjëherë në mënyrë private, për mua personalisht, sikur edhe 10 minuta më parë të kishte ardhur një vendim i tillë, vota ime dhe e grupit tim e ka pro. Faleminderit. Për çështjet e tërmetit, shpjegim.

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Denisa Luarasi: Jo, e ka kërkuar fjalën drejtoresha.

Alneida Rroshi: Të hidhet në votim, të votohet dhe më pas të kalojë në projektvendim nga këshilli.

Munir Konesha: Ça do votojmë?

Alneida Rroshi: Për të përfituar të 10 banorët, të cilët kanë kërkuar të përfshihen.

Flutura Kasa : Duhet ta miratojmë ne.

Alneida Rroshi: Duhet ta miratoni ju.

Denisa Luarasi: Ta miratojmë njëherë, ta kalojmë.
Ja, ta shpjegojë drejtoresha shumë qartë.

..... *Flasin pa mikrofon.....*

Denisa Luarasi Atëherë, ta kalojmë në votim.
Atëherë me 32 vota pro kalon edhe pika shtesë 10 .

***V.O**. Prezent në votim dhe që votuan PRO.*

Ardian Muka, Edlira Shemsi, Luan Nezha, Ermal Braholli, Arjeta Keçi,Mirela Shala, Rolant Xhelilaj, Ana Dhamo, Xhiliola Doçi, Munir Konesha, Alfred Mullaraj, Jonada Mamo, Ervis Bekteshi, Suada Çurri, Alketa Ngjeçi, Ilir Paja, Klementina Meçi, Llesh Çuni, Franc Tragaj, Nurije Gjoni, Hekuran Markola, Silvana Agasi, Aldo Çelaj, Denisa Luarasi, Dorian Isaj, Marsida Feshti, Dritan Rakipi, Joniada Musaraj, Periana Kotri, Kastriot Xhongoli, Flutura Kasa, Florian Tahiri.

Denisa Luarasi : Ju falënderoj shumë për bashkëpunimin.
Po, do ta zbardhë Komisioni Ligjor, patjetër, dhe ngarkohet Bashkia për zbatimin e këtij vendimi.
Faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
Ju uroj pushime të mbara. Mirutakofshim në shtator.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 23 (njëzet e tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesja e seancës (Kryetare e Këshillit Bashkiak), *sekretarja i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.*

Mbajtëse e procesverbalit: Loranda Cani

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtuese e seancës (Kryetare e Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltare (Zv/kryetar i Këshillit) :	MIRELA SHALA
Këshilltari (Kr.Grupi) :	FLORIAN TAHIRI
Këshilltare (Kr. Grupi):	FLUTURA KASA